

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR (SHPK)

“METRO-Alb12”SHPK

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit” , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per shoqerite tregatre” dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Q.K.R” dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin tim te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi me cilesine ne ortakut te vetem , une Adine Petriti shtetase shqiptare, e bija e Qaniut , e datëlindjes 06.02.1952 , lindur ne Korce e banuese ne Korce, në adresën rruga “ Shaban Mukollari, Nr 4 , lagja7 , e njohur në bazë të letërnjoftimit me ID 025987887 me zotësi të plotë juridike për të vepruar, krijoj Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar “METRO-Alb12” sh.p.k duke redaktuar Aktin e Tthemelimit me termat e meposhteme :

NENI 1

Krijimi i shoqerise

Themeloj Shoqërinë Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar te emertuar “METRO-Alb12” Sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar . Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri “METRO-Alb12” Sh.p.k. Veprimtaria e Shoqatës do të rregullohet nga ky akt Themelimi si dhe nga Statuti, që përbëjnë aktet bazë të themelimit të tij.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në kryerjen e veprimtarive (shërbimeve) ne metrologjinë ligjore për kryerjen e verifikimit te instrumenteve mates ligjërishit te kontrolluar, kryerjen e ekspertizës metrologjike, kryerjen e riparimit, verifikimit dhe vulosjes pas riparimit te instrumenteve matës ligjërishit te kontrolluar.



Shoqëria e ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e vendit dhe ka të drejtë të hapë filiale te saj dhe në qytete të tjerë te territorit të Republikës së Shqipërisë , duke respektuar kërkesat e legjislacionit shqiptar për këto çështje.

Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "METRO-Alb12" Sh.p.k. Shoqëria do të ketë edhe vulën e saj e cila përmban emërtimin e saj. Të drejtën e vendosjes së vulës e ka aksioneri i vetëm dhe administratori si person i autorizuar me shkrim prej tij dhe vetëm për veprimtarinë e Shoqërisë.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria e kryen veprimtarinë e saj në fushën e kryerjes së veprimtarive (shërbimeve) në metrologjinë ligjore në Republikën e Shqipërisë për:

- kryerjen e verifikimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar
- kryerjen e ekspertizës metrologjike
- kryerjen e riparimit, verifikimit dhe vulosjes pas riparimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar
- Veprimtaria e shoqërisë kryhet në përputhje me lejet dhe liçensat përkatëse të lëshuara nga organet kompetente shtetërore.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Marigo POZIO" Korçë ALBANIA

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ajo mund të ndërpresë veprimtarinë e vet në menyre të vullnetshme me vendim të organeve drejtuese kompetente të tij sipas statutit të shoqërisë.



NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i aksionerit te vetem themelues të kësaj Shoqërie.

Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 100.000 lekë, shumë e derdhur plotesisht per regjistrimin në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi nga aksioneri themelues të kësaj Shoqërie.

Kapitali i shoqërisë per regjistrim është depozituar në Bankën Raiffeisen Bank – Dega Korce në llogarinë “Shoqëri në Formim e Sipër” dhe në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi. Pas regjistrimit, kjo shumë do të kalojë në llogarinë e kësaj shoqërie që do të çelet pranë po kësaj Banke. Në llogarinë e shoqërisë çelet llogaria “Fondi themeltar i aksionerëve”, ku regjistrohet vlera e kapitalit të tyre.

NENI 7

Kapitali themeltar është i ndarë në 100 aksione me vlerë nominale prej 1 000 lekë.

Aksioneri themelues i Shoqërisë Tregtare te emertuar “METRO-Alb12” Sh.p.k “ zotëron 100% te vleres se aksioneve në kapitalin fillestar te Shoqerise te barabarte me 100 numur aksionesh me kontribut ne vleren 100000 leke.

NENI 8

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve – organi më i lartë vendim-marrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë

NENI 10

Administratori



Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 3 (tre) vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i parë është znj. Daniela CEKANI , shtetase shqiptare, e datëlindjes 17/06/ 1983, lindur në Korçë dhe banues në Tirane, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, numur pasaporte BC8476446

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqsor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga znj. Daniela CEKANI e cila i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 12

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 13.

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Ata detyrohen të rruajnë konfidencialitetin e shoqërisë.

NENI 14.

Aksioneri themelues mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj. Gjithashtu ai vendos edhe për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë apo kalimin e kuotave me kontrate , kontrate e cila duhet të bëhet me shkrim

NENI 15.

Mosmarrveshjet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Korçë.

NENI 16.



Miratimi

Akti i themelimit nenshkrhet rregullisht nga Ortaku I vetem I Shoqerise. Ky Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë për tu shpërndarë në organet kompetente dhe të pakten një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqerise "METRO-Alb12" sh.p.k.

AKSIONERI I SHOQËRISË

Adine PETRITI *Adine Petruti*

